



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 1, 2 pika d) neni 40 të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neni 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, pas propozimit të Kryetarit të Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2026, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 2026 -2030

Neni 1

Miratohet Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026 -2030.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026 -2030

Neni 3

Për zbatimin e këtij Plani do të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe zyra për Informim.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024’’ dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 06/01-6556-2/26

Dt. 29.04.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 2026 – 2030

Dragash, 2026

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
2.	SFONDI	6
2.1.	Profili i Komunës	6
2.2.	Administrata komunale	6
2.3.	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	7
2.4.	Korniza ligjore	8
3.	GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET	8
3.1.	Perceptimet e qytetarëve	9
3.2.	Uebfaqja e komunës dhe platformat sociale	10
3.3.	Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	10
3.4.	Marrëdhëniet me mediat	11
3.5.	Komunikimi i brendshëm	11
3.6.	Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë	12
3.7.	Promovimi dhe marketingu i Komunës	12
3.8.	Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT	13
4.	PARIMET E KOMUNIKIMIT	14
5.	OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT	15
1.	Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat	15
2.	Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje	15
6.	FORMAT E KOMUNIKIMIT	16
7.	AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR	17
8.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	18
9.	MONITORIMI DHE VLERËSIMI	19
	Raportimi	19
	Vlerësimi i Strategjisë	19

Shtojca 1: Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030

I. HYRJE

Kemi kënaqësinë që për herë të parë në institucionin tonë të paraqesim Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030 të hartuar nga Komuna e Dragashit. Ky dokument përfaqëson angazhimin tonë për të ndërtuar një lidhje të fortë dhe të qëndrueshme me komunitetin, duke synuar që të promovojmë transparencën, të rrisim informacionin dhe të krijojmë një platformë të hapur për dialog dhe bashkëpunim me qytetarët, organizatat joqeveritare dhe palët e ndryshme të interesuara.

Duke pasur parasysh sfidat dhe mundësitë aktuale, jemi të përkushtuar që të ofrojmë një komunikim efektiv dhe të përgjegjshëm për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të parimeve themelore të një shoqërie dhe shteti demokratik, siç janë parimet e komunikimit të hapur, informimit të drejtë e të paanshëm, transparencës dhe llogaridhënies.

Në Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030, ne synojmë të identifikojmë nevojat, interesat dhe shqetësimet e qytetarëve, me qëllim që të përgjigjemi në mënyrë efektive. Gjithashtu, përmes këtij dokumenti kemi për qëllim të thelojmë marrëdhëniet tona me publikun, duke u përqendruar në transparencën dhe qasjen tonë të hapur ndaj së drejtës së qytetarëve për t'u informuar. Ne e kuptojmë rëndësinë e një dialogu të ndërsjellë dhe të përmirësuar me komunitetet tona, si parakusht për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme dhe të qëndrueshme.

Strategjia jonë përmban një Plan të Veprimit për të komunikuar me qytetarët dhe për të siguruar që ata të kenë qasje në informacionin e duhur në kohë reale. Në këtë rrugëtim, ne synojmë të promovojmë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të inkurajojmë ndërgjegjësimin e tyre për të kontribuar në zhvillimin dhe mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.

Përtej kësaj, ne jemi të përkushtuar që të përshpejtojmë dhe të përmirësojmë format tona të komunikimit, duke përdorur teknologjinë dhe mediat sociale për të arritur audiencën më të gjerë dhe për të ndarë informacionin në mënyrë efektive. Me një qasje të përqendruar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve tanë, ne synojmë të krijojmë një mjedis të hapur dhe gjithëpërfshirës, duke promovuar bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv në të gjitha nivelet e shoqërisë sonë.

Hartimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030 është bërë i mundur falë punës dhe përkushtimit të Grupit Punues të themeluar nga kryetari i Komunës, me mbështetje të vazhdueshme të përfaqësuesit të OSBE-së.

Komuna e Dragashit në vazhdimësi është përpjekur që t'i përmirësojë dhe avancojë mekanizmat e vet të komunikimit me audiencat e shumta me synimin që t'u përgjigjet dinamikave të reja teknike dhe teknologjike dhe nevojave e kërkesave të qytetarëve për shërbime cilësore dhe informim të saktë e me kohë.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie për informim dhe komunikim është që të mbështesë traditën tashmë të krijuar të komunikimeve të strukturuar në mënyrë që mekanizmat komunikues të jenë efikas, të përshtatshëm e të qëndrueshëm dhe si të tillë të mbështesin përmbushjen e misionit të komunës *për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, përmes komunikimit proaktiv, marrëdhënieve profesionale me mediat dhe krijimit të formave efektive për ndërveprim dhe dialog me qytetarët.*

Kjo *Strategji për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030* është e përqendruar në rritjen e intensitetit të komunikimit dhe informacioneve në Komunën e Dragashit karshi audiencave të synuara dhe përvijon orientimet e administratës komunale për informim me kohë dhe transparencë qeverisëse, komunikim efikas, marrëdhënie të shëndosha me medie dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë, duke përfutur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si forma të komunikimit. Përmes kësaj Strategjie do të kërkohet një reagim proaktiv i audiencave ndaj punës, aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim i marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, medie, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme, duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, *Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030* është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me akterë të ndryshëm, ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Një strategji efikase e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mbështetet fort në kontributin dhe rolin aktiv të të gjithë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këtë arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara, ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për informim, kurse në raste të veçuara do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

2. SFONDI

2.1. Profili i Komunës

Komuna e Dragashit përfshin skajin jugor të Rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me Komunën e Prizrenit, në pjesën juglindore dhe lindore përmes majave të larta të Maleve të Sharrit kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa nga perëndimi dhe jugperëndimi me Shqipërinë. Territori i Komunës së Dragashit shtrihet në një sipërfaqe prej 430 km² dhe zë afër 4% të territorit të Kosovës. Komuna e Dragashit ka relief kodrinor-malor dhe në pjesët kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut e ndajnë kurora të larta malore, ndërsa në drejtim të Shqipërisë gryka të thella lumore, të papërshtatshme për kalim. Në anën tjetër pjesa kodrinore me rrënjë më të butë, në drejtim të Prizrenit, ofron kushte më të mira dhe ky territor lidhet përmes Prizrenit me Kosovën dhe më gjerë. Klima prezente në Komunën e Dragashit është klimë malore-kontinentale e ashpër, ku stina e dimrit është mjaft e gjatë, ndërsa ajo e verës e shkurtër. Klimë subalpine me temperaturë mesatare vjetore prej 8.6°C, vera të shkurtëra dhe të freskëta me temperaturë mesatare prej 18.1°C, me dimra të gjatë. Më shumë se gjysma e territorit të Komunës së Dragashit është e shpallur Park Nacional. Zona të mbrojtura në Komunën e Dragashit janë: Namazxhahu, Mullinjtë dhe Tyrbet.

2.2. Administrata komunale

Administrata komunale në Dragash është e organizuar në 8 drejtori:

1. *Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;*
2. *Drejtoria Komunale e Arsimit;*
3. *Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;*
4. *Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;*
5. *Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit;*
6. *Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike;*
7. *Drejtoria e Bujqësisë, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillimi Rural; dhe*
8. *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.*

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: *Zyra për Integrime Evropiane, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra Ligjore, Zyra për Shërbime Pronësore-Juridike, Zyra e Përkthimit, Zyra për Auditim të Brendshëm, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut.*

Misioni i Komunës:

Komuna e Dragashit synon të forcojë transparencën dhe llogaridhënien institucionale, përmes komunikimit proaktiv, marrëdhënieve profesionale me mediat dhe krijimit të formave efektive për ndërveprim dhe dialog me qytetarët

2.3. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyrtari për Informim dhe zyrtari/ja për Marrëdhënie me Publikun, detyrat dhe përgjegjësitë e veta i kryejnë në kuadër të Drejtorisë së Administratës dhe të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Dragashit, dhe merren me realizimin e një sërë aktiviteteve të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të transparencës ndaj qytetarëve. Përditësimi i vazhdueshëm i uebfaqes zyrtare të Komunës - në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, qoftë përmes publikimit të lajmeve dhe informatave për aktivitetet e përditshme të institucionit, si dhe përmes publikimit të dokumenteve dhe vendimeve të rëndësishme të ekzekutivit dhe legjislativit lokal, të cilat janë me interes të përgjithshëm - përbën një ndër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të zyrtarit përgjegjës për Informim dhe zyrtarit për Marrëdhënie me Publikun. Gjithashtu, marrin pjesë në të gjitha aktivitetet dhe takimet zyrtare të kryetarit të Komunës, si dhe në aktivitetet dhe organizimet e zhvilluara nga Kuvendi i Komunës dhe organet tjera të Administratës komunale dhe stafit politik. Për këto aktivitete publikohen në vazhdimësi lajme dhe informacione në të dy gjuhët zyrtare, në uebfaqen zyrtare dhe Facebook. Në bashkëpunim me drejtoritë dhe zyrtarët përkatës komunalë publikohen lajme, njoftime, konkurse, thirrje publike, procesverbale, raporte dhe dokumente të ndryshme publike me interes të përgjithshëm, çdo herë sipas kritereve të parapara ligjore.

Kanalet kryesore të komunikimit të Komunës së Dragashit me publikun janë uebfaqja zyrtare e Komunës dhe rrjeti social Facebook, ku bëhet publikimi i vazhdueshëm i të gjitha aktiviteteve të institucionit. Këto kanale menaxhohen nga Zyra e IT-së, zyrtari përgjegjës për Informim dhe zyrtari për Marrëdhënie me Publikun. Komuna e Dragashit, për punën dhe aktivitetet e veta publike bashkëpunon edhe me mediumet lokale private, siç janë Radio Sharri, Televizioni Opoja, Radio Bambus, Radio Gora etj., audienca e të cilave përfshin qytetarët nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Komunën e Dragashit.

2.4. Korniza ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Dragashit – përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për Transparencë 01Nr.060-6335/1 – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Dragashit dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 06/L-081 - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha uebfaqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Me qëllim të rritjes së transparencës në punë të organeve të Komunës, Kuvendit të Komunës, kryetarit dhe organeve të Administratës lokale, si dhe me krijimin e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të së drejtës së qytetarëve për informim, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare komunale, Komuna e Dragashit e ka të hartuar Rregulloren për Transparencë 01 Nr. 060-6335/1 të datës 27.04.2017. Kjo Rregullore do të ndryshohet, plotësohet dhe

harmonizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, varësisht nga ndryshimet e mundshme të këtij legjislacioni.

Hartimi i kësaj Strategjie për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun është një hap tjetër i rëndësishëm, i ndërmarrë nga Komuna e Dragashit në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së nivelit të komunikimit me publikun. Ky dokument hartohet për herë të parë nga Komuna e Dragashit dhe do të ndikojë në masë të madhe në cilësinë e punës së organeve komunale lokale për të ndërtuar marrëdhënie sa më transparente mes institucionit dhe qytetarëve.

Sa u përket aktiviteteve të informimit, Komuna e Dragashit i realizon kryesisht përmes platformave online si uebfaqja zyrtare e Komunës dhe rrjeti social Facebook, si dhe përmes medimeve lokale private të cilat veprojnë në Komunën e Dragashit. Mënyra elektronike e komunikimit me publikun është një formë më e lehtë dhe praktike, e cila u mundëson qytetarëve qasje më të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në informim lidhur me punët dhe aktivitetet e Komunës dhe organeve lokale. Gjithashtu, kryetari dhe organet komunale në vazhdimësi realizojnë takime publike, dëgjime buxhetore, konsultime publike me qytetarë për dokumente të tjera me interes të përgjithshëm.

3.1. Perceptimet e qytetarëve

Sa i përket perceptimit të qytetarëve dhe nivelit të kënaqshmërisë së tyre në raport me qasjen në informacione publike, pjesëmarrjes së qytetarëve në diskutime publike, ofrimit të shërbimeve të ndryshme administrative, cilësisë së punimeve etj., nga raportet e organizatave të besueshme rezulton se qytetarët e Komunës së Dragashit janë relativisht të kënaqur me performancën e përgjithshme të institucioneve komunale. Sipas Anketës mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve 2023 (DEMOS&HELVETAS, Mars 2024)¹, 53% e qytetarëve nga Komuna e Dragashit “raportuan nivelet më të larta të informacionit, duke u shprehur se janë shumë mirë/plotësisht të informuar”. Gjithashtu, sa i përket pjesëmarrjes (angazhimit) së qytetarëve në takime publike që organizon Komuna, gjetjet e këtij raporti tregojnë se, në krahasim me komunat tjera, takimet publike kanë parë pjesëmarrje më të madhe në Komunën e Dragashit (30%). Ky raport prezanton edhe nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me cilësinë e punimeve nëpër komuna. Nga gjetjet e këtij raporti del se 90% e qytetarëve të anketuar nga Komuna e Dragashit ishin më së shumti të kënaqur për cilësinë e punimeve në komunën e tyre. Nga të dhënat e të anketuarve, një përqindje relativisht e lartë e qytetarëve (69%) nga Komuna e Dragashit kanë deklaruar se kanë gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar. Lidhur me perceptimin e qytetarëve në raport me rolin e organit legjislativ lokal (Kuvendin e Komunës së Dragashit), nga të dhënat e anketës rezulton se qytetarët nga Komuna e Dragashit janë të dytët, pas qytetarëve nga Komuna e Klinës, të cilët kanë treguar vetëdijen më të lartë për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit Komunal (75%). Në pyetjen se deri në çfarë mase pajtoheni që Kuvendi i Komunës arrin të mbajë përgjegjësi

¹ <https://helvetas-ks.org/demos3/wp-content/uploads/2024/03/Citizen-Satisfaction-Survey-ALB.pdf>

ekzekutivin (kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale), 96% e të anketuarve nga Komuna e Dragashit pajtohen ose pajtohen plotësisht.

3.2. Uebfaqja e komunës dhe platformat sociale

Në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit publikohen të gjitha dokumentet publike me interes të përgjithshëm, duke përfshirë të gjitha vendimet e kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, rregulloret, strategjitë dhe planet e veprimit. Gjithashtu, në uebfaqe zyrtare publikohen të gjitha dokumentet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit, si dhe informata, njoftime dhe publikime të ndryshme, duke përfshirë edhe draftdokumentet për konsultim me publikun, së bashku me procesverbalet dhe raportet.

Platforma e rrjetit social Facebook përdoret kryesisht për publikimin e informatave lidhur me aktivitetet dhe takimet zyrtare të kryetarit të Komunës, kryesuesit/es të Kuvendit, informimit për ecurinë e investimeve kapitale, publikimin e thirrjeve publike për mbështetje financiare etj.

3.3. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Aktualisht, Komuna e Dragashit ka të hartuar Rregulloren për Transparencë 01 Nr. 060-6335/1 të datës 27.04.2017 dhe Planin Komunal për Integritet, si dokumente të rëndësishme të harmonizuara me legjislacionin në fuqi lidhur me ngritjen e nivelit të transparencës dhe përgjegjshmërisë komunale në raport me qytetarët.

Gjatë viteve 2022-2025, Komuna e Dragashit ka shënuar përmirësim të dukshëm sa i përket nivelit të transparencës dhe komunikimit me publikun. Si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së përgjithshme, për herë të katërt radhazi është radhitur në mesin e komunave përfituese të Grantit të Performancës. Sipas Indeksit të Transparencës në Qeverisjen Komunale për vitin 2022 të KDI-së, Komuna e Dragashit është radhitur në mesin e dhjetë komunave më transparente në Kosovë (82.73 pikë), duke shënuar kështu një ngritje prej tetë vendeve në krahasim me vitin paraprak 2021 (63.74 pikë), ndërsa në vitin 2024 arrin 85 pikë ose 88.54% në indexin e transparimetrit komunal për 2024.

Në fushën e konsultimeve publike me qytetarët për hartimin e dokumenteve të ndryshme, si dhe atë të dëgjimeve buxhetore për hartimin e dokumenteve buxhetore të Komunës, për herë të parë janë krijuar në uebfaqen zyrtare rubrikat e veçanta ku bëhet publikimi i të gjitha njoftimeve për dëgjime buxhetore dhe konsultime publike me qytetarë, draftdokumenteve për konsultim me publikun, si dhe procesverbaleve dhe raporteve për ecurinë e përgjithshme të konsultimeve publike, takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore. Kjo do të ndikojë në masë të madhe në rritjen e transparencës dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve dhe organizatave të ndryshme në këto dokumente. Gjithashtu, me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në informim lidhur me shërbimet që ofron Komuna, është hartuar Lista e Hollësishme e Shërbimeve, e cila është publikuar në uebfaqen zyrtare.

3.4. Marrëdhëniet me mediat

Aktualisht, në territorin e Komunës së Dragashit operon një televizion lokal (Televizioni Opoja) dhe disa radio lokale (Radio Sharri dhe Radio Bambus), me të cilat Komuna ka të nënshkruara kontrata të bashkëpunimit dhe të cilat kanë një audiencë të gjerë nga të gjitha komunitetet. Ky numër i medimeve lokale ka një mbulueshmëri të gjerë të informimit në të gjithë territorin e Komunës së Dragashit.

Të gjitha këto medime i kanë edhe platformat e tyre online në rrjetin social Facebook, me një numër të konsiderueshëm ndjekësish, të cilat shërbejnë si kanale të rëndësishme komunikimi dhe transmetimi të punës dhe aktiviteteve të organeve publike lokale.

Gjatë viteve në vijim, Komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikën tashmë të zbatuar të komunikimit, themelimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të Zyrës për Informim, si dhe ndërtimit të marrëdhënieve të shëndosha me mediat. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformave të komunikimit social dhe mirëmbajtjes e përditësimit të vazhdueshëm të uebfaqes zyrtare të Komunës, në përputhje me praktikën më të mira që lidhen me përmirësimin e nivelit të transparencës dhe përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje. Për këtë qëllim do të shqyrtohet edhe mbajtja e konferencave për shtyp, si një praktikë e mirë e komunikimit të drejtpërdrejtë me mediat dhe qytetarët lidhur me aktivitetet e përditshme të institucionet.

3.5. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi i brendshëm i administratës komunale është avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka ndikuar në ngritjen e përgjithshme të performancës së stafit administrativ, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikën në rritje të qeverisjes lokale. Komunikimi i Kryetarit të Komunës me drejtorët komunalë paraqet një shembull pozitiv të bashkëpunimit, me qëllim të organizimit efikas të punëve dhe aktiviteteve të institucionit. Për të qenë sa më transparente për publikun, mbledhjet e Bordit të Qeverisë Lokale me të gjitha pikat e rendit të ditës publikohen në mënyrë të vazhdueshme në uebfaqe zyrtare dhe Facebook.

Përmes hartimit të Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030, synohet që të specifikohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve përkatës të institucionit, në mënyrë që të krijohen kushtet për një komunikim efikas ndërmjet zyrtarëve dhe organeve komunale gjatë kryerjes së detyrave dhe ofrimit cilësor të shërbimeve për qytetarët. Njëkohësisht, kjo do të ndikojë edhe në promovimin e një kulture organizative dhe në shkëmbimin e përvojave pozitive ndërsektoriale.

Komuna e Dragashit ka një nivel të kënaqshëm të komunikimit ndërmjet organeve ekzekutive dhe legjislativ. Në të gjitha mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit merr pjesë kryetari i Komunës, i cili së bashku me drejtorët komunalë u përgjigjet pyetjeve të kuvendarëve në lidhje me ecurinë e punëve dhe aktivitetet e zhvilluara nga ekzekutivi lokal.

3.6. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna e Dragashit në vazhdimësi është përpjekur që të zbatojë praktika të frytshme të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, OJQ-të dhe mediat. Ky bashkëpunim është i fokusuar kryesisht në ofrimin e mbështetjes financiare të organizatave të ndryshme të cilat zhvillojnë projekte që kanë për qëllim zhvillimin kulturor e sportiv, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në kujdesin shëndetësor dhe ruajtjen e ambientit. Gjithashtu, Komuna bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile gjatë hartimit të dokumenteve dhe akteve politike, me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të palëve të ndryshme të interesuara në procesin e vendimmarrjes, si dhe në hartimin e raporteve për vlerësimin e nivelit të performancës dhe transparencës komunale.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë shërbyer si një shembull i mirë i ndërtimit të raporteve pozitive që synojnë përmirësimin e nivelit të mirëqenies së qytetarëve, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për institucionet lokale në Dragash, përmes nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit.

3.7. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Promovimi i aktiviteteve komunale përmes formave të ndryshme të komunikimit është një aspekt shumë i rëndësishëm i rritjes së transparencës dhe informimit sa më të drejtë të publikut, duke përfshirë edhe pasqyrimin e aktiviteteve ekonomike e kulturore, si dhe vlerave të trashëgimisë dhe turizmit. Komuna është në kërkim të vazhdueshëm për forma edhe më kreative dhe ekonomishtë të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale. Përmes një game të gjerë të aktiviteteve dhe veprimeve, Komuna synon të ndërtojë imazhin e saj në publik dhe të rrisë mundësitë për të tërhequr vizitorë, investitorë, dhe për të zhvilluar potencialin e turizmit dhe të ekonomisë së saj.

Në të ardhmen, Komuna do të sigurohet që të zhvillojë edhe platforma të reja më të qëndrueshme, të cilat do të shërbejnë si burime të besueshme për të gjithë qytetarët brenda dhe jashtë vendit, për t'u informuar lidhur me aktivitetet që zhvillon institucioni për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe turistike. Komuna e Dragashit organizon një sërë aktiviteteve kulturore, sportive, por edhe ekonomike. Në fushën e Kulturës kemi aktivitetet si: Festivali Folklorik Ballkanik i Valleve "Opoja Vallëzon", Sofra e Ymer Prizrenit, Ditët e Mërgatës në Bellobrad dhe tek Liqeni i Breznes, Ditët e Mërgatës në Restelicë, Brod, Košce dhe Dragash. Pastaj në fushën e Sportit organizohen aktivitete si Vrapimi i Kuajve, Garat e Skitarisë në Brod, Marshi i Motokrosit, Garat e Çiklizmit etj. Në fushën e zhvillimit ekonomik, Komuna e Dragashit organizon Panairin e Produkteve Vendore Lokale "EXPO SHARRI", ndërsa merr pjesë edhe në ngjarje të tjera si: Panairi i Turizmit dhe Sportit, Panairi "AGROKOS" etj. Të gjitha këto përbëjnë një potencial për zhvillim ekonomik e turistik të Komunës dhe kërkojnë angazhim më të madh institucional për krijimin e standardeve dhe mekanizmave të qëndrueshëm të komunikimit për promovimin e këtyre vlerave kulturore dhe turistike. Po ashtu, për promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore,

Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me OJQ “Avoko” ka lansuar platformën online Visit Dragash ².

3.8. Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT

PËRPARËSITË E KOMUNIKIMIT

- Uebfaqe zyrtare e komunës funksionale dhe përditësuar në gjuhët zyrtare
- Është vendosur një mekanizëm i qëndrueshëm i komunikimit në rrjete sociale
- Përditësim i rregullt dhe me kohë i të dhënave dhe dokumenteve publike
- Staf i motivuar për komunikim dhe transparence i Kabinetit të Kryetarit

MUNDËSITË

- Të analizohen metodat tjera për rritjen e transparencës dhe komunikimit me qytetarët dhe banorët
- Formimi i grupeve të komunikimit në aplikacionet e ndryshme (Whats Up; Viber) me përfaqësues të fshatrave
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbi ngritjen e nivelit të transparencës dhe komunikimit
- Shtimi i kapaciteteve njerëzore në Zyrën për Komunikim dhe Informim
- Teknologji lehtësisht të qasshme për të realizuar video promociionale me kosto të ulët

DOBËSITË

- Dizajni i uebfaqes i krijuar në formën unike për të gjithë
- Vegëzat dhe qasja në dokumentet e publikuara mund të përmirësohet duke përfshirë edhe dizajnin
- Aktivitetet nga drejtorët të dorëzohen në kohë sa më të shpejtë për procesim deri në publikim të tyre
- Teknologjia e mirëfilltë në përmirësim të performancës së zyrës

RREZIQET

- Uebfaqja e komunës herë pas here bëhet jofunksionale (kompetencë e nivelit qendror)
- Vullneti i munguar politik nga niveli qendror për ridizajnim të uebfaqes
- Ndryshim i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative mbi transparencën
- Tendencë në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe mediumeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi – në kërkim të sensacionit

² www.visitdragash.com

4. PARIMET E KOMUNIKIMIT

Komuna e Dragashit angazhohet në mënyrë të vazhdueshme që praktikatat e veta të informimit dhe komunikimit me publikun t'i bazojë në parimet demokratike të së drejtës themelore të qytetarëve për qasje të lirë dhe të plotë në informacionet lidhur me aktivitetet e Komunës. Në veçanti, Komuna gjithmonë merr parasysh kriteret e publikimit të informacioneve në të gjitha gjuhët e komuniteteve që jetojnë brenda territorit të Komunës së Dragashit, duke u përpjekur që t'i qëndrojë besnik parimit të mosdiskriminimit në aspektin gjuhësor.

Informimi i drejtë – nënkupton përkushtimin e Komunës që të gjitha punët dhe aktivitetet e institucionit t'i publikojë në mënyrë të drejtë, të saktë dhe të paanshme, duke u bazuar në parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Informimi i kohshëm – nënkupton informimin e qytetarëve në baza ditore dhe, kur është e mundur edhe në kohë reale (livestream), për të gjitha aktivitetet e zhvilluara, vendimet, aktet e ndryshme, diskutimet publike etj., në mënyrë që të krijohen kushtet sa më të përshtatshme për bashkëveprim të vazhdueshëm me qytetarët dhe përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.

Ndërveprimi – nënkupton ofrimin e mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të performancës së saj.

Githëpërfshirja dhe mosdiskriminimi – nënkupton që e gjithë veprimtaria publike e organeve komunale do të arrijë të të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit, me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni.

Transparenca dhe llogaridhënia – Komuna do të jetë e hapur, transparente dhe llogaridhënëse për secilin aktivitet të ndërmarrë, me qëllim të përmirësimit të përgjithshëm të nivelit të mirëqenies dhe ofrimit sa më cilësor të shërbimeve për qytetarët.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit, duke përfshirë televizionet, radiot, portalet elektronike, uebfaqen e Komunës, rrjetet sociale etj.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Konsultimi është proces i nxitjes së ofrimit të informatave apo mendimeve nga grupet e interesuara me qëllim të përmirësimit të cilësisë së vendimeve të qeverisë.

Përmes hartimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike dhe planeve të veprimit për transparencë dhe komunikim, Komuna e Dragashit synon përmbushjen e objektivave strategjikë dhe specifikë që përmirësojnë në mënyrë cilësore nivelin e komunikimit efektiv dhe informimit, si në rrafshin e brendshëm institucional, po ashtu edhe në raport me qytetarët, mediat, akterët dhe palët e ndryshme të interesuara.

Komuna e Dragashit ka vendosur standardet dhe parimet e komunikimit të rregullt me qytetarët dhe në vazhdimësi këto parime dhe praktika do të avancohen dhe theksohen edhe më tepër.

Për të zhvilluar një komunikim sa me efikas me publikun, komuna është duke u përpjekur në mënyrë të vazhduar të gjejë format më të përshtatshme të komunikimit dhe në të njëjtën kohë është duke adaptuar profesionalizmin e stafit në raport me këto nevoja. Stafi i Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun është duke u kompletuar dhe avancuar në përdorimin e teknologjisë në komunikimet e tyre me publikun.

Komuna e Dragashit ka përcaktuar dy (2) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

1. *Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat; dhe*
2. *Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.*

1. *Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat*

Komuna e Dragashit është duke rishikuar prioritetet ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet te paraqitjet e strukturuar mediatike, shumëllojshmërisë së formave dhe materialeve komunikuese, përdorimit më të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, Komuna do të sigurohet që personeli në ZKI të trajnohet për përdorimin efikas të tyre. Po ashtu, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet konsolidimit të marrëdhënieve me mediat, e sidomos atyre lokale, të cilat numerikisht janë të vogla, por që ofrojnë një ndihmë të madhe në informimin e drejtë dhe të saktë në raport me veprimtarinë e institucioneve komunale.

2. *Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje*

Kjo Strategjie synon që t'u mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitetet e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të aplikojë një qasje komunikimi e cila hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Komuna do të vazhdojë të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, dhe do të stimulojë pjesëmarrjen e qytetarëve në

vendimmarrje duke kultivuar një bashkëpunim të avancuar me organizatat lokale të shoqërisë civile dhe grupet tjera të interesit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë komuniteteve në vendimmarrjen komunale.

6. FORMAT E KOMUNIKIMIT

Komunikimi institucional i komunës me publikun ka ekzistuar ndër vite në forma të ndryshme. Ajo është zhvilluar nga forma e lajmërimeve nëpër tabela të vendosura në lokacione përkatëse, thirrje përmes mesazheve në radio lokale, komunikime individuale me përfaqësues të komuniteteve, e-maileve, internetit, e kohëve të fundit është duke u zhvilluar edhe me shfrytëzimin e rrjeteve sociale. Këto forma komunikimi aplikohen edhe tani, varësisht nga pranueshmëria dhe arritshmëria e porosisë të publiku. Në disa raste dhe situata aplikohet një formë, e në disa raste tjera forma të kombinuara të komunikimit me qëllimin e vetëm që të arrihet informacioni i plotë, i saktë dhe i duhur për publikun, dhe nëse kërkohet angazhimi përcjellës nga ana e publikut të sigurohemi se ata do ta gjejnë.

Forat konkrete të komunikimit që përdor komuna, dhe jo vetëm, të cilat mundësojnë ndërveprim, janë: *Emaili, intraneti qeveritar, aplikacionet qeveritare, uebfaqja e Komunës, latformat e komunikimit social, mediat, publikimet, videot dhe fotografitë, takimet e strukturuar dhe të planifikuara, tabelat e informimit, broshurat dhe fletushkat, adresimet për qytetarë në tubime të ndryshme etj.*

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

AUDIENCA	MESAZHI:	IMPAKTI I DËSHIRUAR:
Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive	Komuna e Dragashit është e përkushtuar që të përmirësojë cilësinë e komunikimit dhe të sigurojë që qytetarët janë të informuar për aktivitetet komunale në çdo kohë	Të ndihen dhe shprehen të kënaqur për cilësinë e informimit të tyre nga ana e komunës
Mediat	Udhëheqja komunale është e përkushtuar për të rritur cilësinë e shërbimeve	Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, të saktë, të sinqertë dhe të paanshme
Organizatat e shoqërisë civile	Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve.	Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre.
Komuniteti i biznesit dhe investitorët e mundshëm	Komuna e Dragashit mbështetë krijim e një ambienti miqësor për të bërë biznes.	Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre.
Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët	Komuna është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes.	Ta konsiderojnë Komunën si partner të besueshëm në iniciativa.

8. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Për arritjen e objektivave kryesorë të përcaktuar nga Komuna e Dragashit, parakusht i rezultatit pozitiv është përmirësimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale. Nuk mund të vendoset dhe zhvillohet një komunikim i shëndoshë dhe i konsoliduar me publikun përderisa nuk kemi zhvilluar dhe vendosur në binarë komunikimin e brendshëm institucional. Me këtë nënkuptojmë se administrata komunale duhet ta ketë të qartë se në këtë proces ka një rol kyç dhe secili seksion i komunës apo zyrtar, duhet ta kuptojë se kur është momenti që ai duhet të kyçet në proces. Kur të kuptohet dhe pranohet roli i të gjithë administratës në procesin e komunikimit, atëherë mund të vazhdojmë me hapat tjerë të komunikimit dhe dy parimet e vendosura si objektiva kryesore të kësaj strategjie.

Kryetari i Komunës	<i>Drejton politikën e komunës dhe propozon rregullore apo akte tjera për miratim në Kuvendin e Komunës</i>
Zyrtari Komunal për Informim	<i>Lehtëson procesin administrativ të komunikimit dhe në raste të konsultimit publik</i>
Drejtorët e drejtorive komunale	<i>Kontribuojnë në përgatitjen e shkresave dhe njoftimeve për aktivitetet e drejtorive përkatëse</i> <i>Marrin pjesë në takime publike së bashku me zyrtarin apo grupin punues përgjegjës për hartimin e projektpropozimit; janë përgjegjës për zhvillimin e konsultimit publik</i>
Të punësuarit në administratën komunale	<i>Ndihmojnë dhe kontribuojnë në procesin e përgatitjes së aktit, si grup punues apo të emëruar</i>

Vetëdijësimi i administratës komunale për marrjen e përgjegjësiave dhe roleve në implementimin e strategjisë së komunikimit është i rëndësishëm dhe parashihet të bëhet përmes këtyre aktiviteteve të listuar më poshtë:

1. Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm (Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe ZKI);
2. Hartimi i Udhëzuesit për komunikim me email zyrtar, duke krijuar një grup me zyrtarë nga secila drejtori (Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe ZKI);
3. Azhurnimi i Programit për Trajnime dhe ngritje profesionale (Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe Njësia e Personelit);
4. Takimi i Përgjithshëm (I) me stafin e administratës (Kryetari i Komunës, Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe Njësia e Personelit).

9. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026–2030 do të sigurojë që aktivitetet dhe masat e parashikuara të zbatohen në mënyrë efektive dhe në përputhje me objektivat strategjike të komunës.

Procesi i monitorimit do të synojë të:

- përcjellë progresin e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara;
- vlerësojë efektivitetin e mekanizmave të komunikimit dhe informimit publik;
- identifikojë sfidat dhe nevojat për përmirësim gjatë zbatimit të strategjisë;
- sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në raportimin e rezultateve.

Raportimi

Për zbatimin e strategjisë do të përgatiten:

- **raporte vjetore të zbatimit**, të cilat do të përmbledhin progresin e arritur në realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- analiza të rezultateve të arritura në raport me objektivat e strategjisë.

Raportet e monitorimit do t'i prezantohen strukturave drejtuese të komunës dhe do të shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit institucional.

Vlerësimi i Strategjisë

Përveç monitorimit të rregullt, strategjia do t'i nënshtrohet edhe procesit të vlerësimit për të analizuar ndikimin dhe efektivitetin e saj.

Vlerësimi mund të realizohet përmes:

- analizës së indikatorëve të performancës;
- vlerësimit të nivelit të transparencës institucionale;
- analizës së pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset komunale;
- matjes së nivelit të ndërveprimit me publikun dhe mediat.

Shtojca I: Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030

OBJEKTIVI 1: KRIJIMI I MEKANIZMAVE EFIKAS PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME MEDIAT					
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	INDIKATORËT	KOSTOJA
<i>Krijimi i databazës së medive</i>	Evidentimi i medive lokale dhe kombëtare, dhe krijimi i listës së kontakteve	ZIMP	2026	Lista funksionale e medive	<i>Pa kosto shitesë</i>
<i>Publikimi i rregullt i komunikatave për media</i>	Publikimi i komunikatave për aktivitetet dhe vendimet komunale	ZIMP	Në vazhdimësi	Numri i komunikatave të publikuara	<i>Pa kosto shitesë</i>
<i>Organizimi i konferencave për media</i>	Konferenca periodike për informimin e medive mbi vendimet dhe projektet komunale	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim	Në vazhdimësi (sipas nevojës)	Numri i konferencave	<i>Pa kosto shitesë</i>
<i>Trajnimi i stafit për komunikim publik</i>	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët komunalë mbi komunikimin me publikun dhe mediat	Njësia e Burimeve Njerëzore	2027	Numrit i stafit të trajnuar	<i>Mjete që do të sigurohen nga donatorët</i>
<i>Përmirësimi i uebfaqes komunale</i>	Përditësimi dhe strukturimi më i mirë i përmbajtjes informative në uebfaqe	ZIMP IT	2026 2027	Rritja e publikimeve online	<i>Pa kosto shitesë</i>
<i>Hartimi i Planit Vjetor të Komunikimit</i>	Planifikimi i aktiviteteve informuese dhe komunikimit publik gjatë vitit	ZIMP	Çdo vit	Plani i publikuar	<i>Pa kosto shitesë</i>
<i>Prodhimi i përmbajtjeve multimediale</i>	Realizimi i videove të shkurtra informuese për projektet dhe shërbimet komunale	ZIMP	Në vazhdimësi	Numri i videove të publikuara	<i>Pa kosto shitesë</i>

OBJEKTIVI 2: RRIJTJA E TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE					
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	INDIKATORËT	KOSTOJA (€)
<i>Krijimi i listave të kategorizuara të kontakteve me audiencat e jashtme</i>	Krijimi i listave të kontakteve të OJQ-ve, bizneseve etj.	Shefi i Kabinetit të kryetarit ZIMP Zyra IT	2026	Lista funksionale me kontakte të përditësuara	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Organizimi i takimeve publike me qytetarë</i>	Takime të rregullta informuese me komunitetin	Kryetari i Komunës Drejtoritë	Në vazhdimësi	Numri i takimeve	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Publikimi i videomaterialeve që promovojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen komunale</i>	Nxjtja e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe konsultime publike	ZIMP	Çdo P viti	Numri i videoeve të publikuara	<i>(mjete që do të sigurohen nga donatorët)</i>
<i>Konsultimet publike për dokumente të politikave të komunës</i>	Organizimi i konsultimeve publike për plane, strategji dhe rregullore	ZIMP Kabineti i Kryetarit Kuvendi Drejtoritë komunale	Në vazhdimësi	Numri i konsultimeve	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Publikimi i dokumenteve komunale</i>	Publikimi online i vendimeve, rregulloreve dhe dokumenteve strategjike	ZIMP IT	Në vazhdimësi	Numri i dokumenteve të publikuara	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Zhvillimi i platformave për komunikim me qytetarë</i>	Përdorimi i rrjeteve sociale dhe platformave digjitale për komunikim	ZIMP	Në vazhdimësi	Numri i ndërveprimeve	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Transparenca buxhetore</i>	Publikimi i dokumenteve dhe informacioneve mbi buxhetin komunal	ZIMP Drejtoria e Financave	Çdo vit	Numri i raporteve të publikuara	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Krijimi i Listës së Prioriteteve të Fshatrave</i>	Identifikimi i prioriteteve zhvillimore përmes takimeve	ZIMP Kabineti i Kryetarit	Çdo vit	Lista e krijuar	<i>Pa kosto shtesë</i>

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-6556-2/26

Dt. 29.04.2026

**Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu**



[Handwritten signature]